



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisoni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

***Lenda:* “MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERIN LLAZAR DEVOLE”**

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetur në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “, VKB-së nr.3, datë 30.01.2026 “Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2029”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

I ndjeri Llazar Devole, person i identifikuar në situatë rruge, pa banesë të qëndrueshme, njëhej si i braktisur nga familjarët, të afërm dhe jetonte kryesisht në rrugë, hapësira të hapura duke u përballur me kushte të vështira jetese dhe mungesë të plotësimit të nevojave bazike si higjena, kujdesi shëndetësor, strehimi. Prej viti 2021 drejtoria e Shërbimit Social ka dërguar kërkesa të vazhdueshme për pranimin e z.Devole në shërbim rezidencial, institucion për perkujdesjen e moshës së tretë dhe shoqata në fushën e perkujdesjes dhe integritit social për persona që jetojnë në kushte të papërshtatëshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Përherë kërkesat janë refuzuar dhe i ndjeri ka vazhduar të qëndrojë në banesën e tij në katin e parë në lagjen “30 Vjetori” e cila ishte plotësisht e pabanueshme dhe e papërshtatëshme për të jetuar.

Situata Financiare

Nga strukturat e shërbimit social, është vlerësuar situata e vështirë e jetesës që i ndjeri ka pasur dhe pamundësia, pavarësia që atij i mungonte për tu kujdesur për veten

Me Vendimin nr.89, datë 04.12.2025, të KB i ndjeri është sistemuar si rast emergjent rezident pranë Qendrës “Lira” Berat me kërkesë të Drejtorisë së Shërbimit Social.

Duke u bazuar në historikun, problematikat e rastit dhe vlerësimin social nga strukturat e shërbimit social, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit si person pa të afërm, kërkesës së paraqitur nga **drejtori i Shërbimit Social**, propozon të përballoj shpenzimet e varrimit, në shumën 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

A është objekt i konsultimit publik:

Ky material nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**” , i mbledhur në datën 27/02/2026, shqyrtoi projekt vendimin “**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERIN LLAZAR DEVOLE**”

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste fatkeqësie, për të ndjerin Lllazar Devole në shumën 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë.
2. Shuma prej 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2026.
3. Pagesa do të bëhet për llogari të subjektit që ka lëshuar faturën tatimore, i cili ka mundur shërbimin e varrimit.

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Velu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 27/02/2026